- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

##### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

##### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca 2.**

**Loti 1:** “Shërbime për realizimin e eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE):

\_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t’u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (4 x 5X)</b>	
1	LED 4x3m	copë	2			
2	Strukturë Layer per 2 Led Wall 4x4m -32m2	m2	32			
3	Stage 8x3m	m2	24			
4	Dekorimi – tavolina të larta	copë	70			
5	Dekorimi – mbulesa të zeza	copë	70			

	material i plotë					
6	Ndricimi (LED, pare indoor)	copë	30			
7	Shërbim DJ	person	1			
8	Ekuipezhi i skenave dhe zërit (teknikët e zërit, teknikët e ndriçimit)	shërbim	1			
9	Qera Mikser për DJ	copë	1			
10	Prodhim Skenografi/Planimetri të Eventit	copë	1			
11	Foltore e Branduar	copë	1			
12	Dekorimi Skena - kolltuqe velvet	copë	6			
13	Dekorim Skena - karrige te larta	copë	10			
14	Dekorimi Skena - tavolina të vogla plexiglass transparente 40x40cm	copë	6			
15	Banakë Rregjistrimi, të branduar	copë	2			
16	Dekorimi - karrige të ulëta transparente	copë	250			
17	Infopoint Corner/Media Booth (një hapësire e branduar akomoduese dhe e pajisur me materiale dixhitale dhe interaktive)	copë	1			
18	Infopoint Corner/Media Booth (tabele interaktive) - qira për dy ditë	copë	1			
19	Sistemi Audio i Brendshëm (skena me kapacitet 200 +) shërbim për dy ditë	sistem	1			
20	Stenda Interaktive Panairi (koncept panairi teknologjie të pajisur me ekrane interaktive, porta elektrike dhe sistem monitorimi)	copë	10			

21	Qera Hapësire Multidimensionale, me mundësi akomodimi për skena dhe evente paralele, si dhe hapësire për panairë teknologjike, për të akomoduar në lëvizje dhe hapësira të paktën 500 persona. Kostot janë llogaritur për 3 ditë (1 ditë parapërgatitore dhe 2 ditë event)	copë	1			
22	Zhvillimi i brandbook për eventin	shërbim	1			
23	Shërbim Videografi/Montim 2 ditë	shërbim	1			
24	Shërbim Fotografi 2 ditë	shërbim	1			
25	Spote Promovuese 30 sec	copë	15			
26	Shërbim Regjie dhe Skenografie	shërbim	1			
27	Zhvillim Aplikacioni për Menaxhim Event, me veçori si regjistrimi i përdoruesve, faqet e personalizuar të eventit dhe axhendes, biletat, njoftimet, mjetet e angazhimit të pjesëmarrësve, analitika në kohë reale, listimet e ekspozuesve/sponsorëve, përvojat AR, pagesa të sigurta dhe mbështetje shumëgjuhëshe	shërbim	1			
28	Speech to text AI Specifikim: Transkriptim live shqip dhe anglisht dhe shfaqja e tyre në stream	shërbim	1			
29	Televizore me Rrota ose Mekanizëm Levizes	copë	10			
30	Shërbim për optimizimin e SEO/Google	shërbim	1			

31	Shërbim Master of Ceremony	shërbim	1			
32	Tarifa për folësit nga Ballkani	person	10			
33	Tarifa për folësit nga Europa	person	10			
34	Tarifa për folësit nga Amerika/Australi/Azi/Afrika	person	5			
35	Pritje me Koktail dhe Catering	150 persona /ditë	1			
36	Lunch boxes	250 persona /ditë	2			
37	Refreshments (kafe, uje, caj)	250 persona /ditë	2			
38	Totebags te Branduar	copë	200			
39	Badges	copë	200			
40	Bllok format A5 cover me karton 300gr i printuar me design, letra e brendshme pa viza	copë	200			
41	Stilolapsa të branduar	copë	200			
42	Roll ups 85x 200 cm	copë	6			
43	Shërbim Montim/Cmontim/Transport - nevojiten burime për ngritjen e skenave të ndryshme, rregullimin e ulëseve ose zonave të ekspozitës/panairit	shërbim	2			
44	Koordinim Eventi, gjatë ditëve në terren	shërbim	1			
45	Pishtar zjarri i madh me diameter të pakten 1 metër	copë	1			
					<b>Çmimi total</b>	_____

---

<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>		
<b>TVSH (%)</b>		
<b>Çmimi total me TVSH:</b>		
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>		
<b>Nënshkrimi</b>		
<b>Vula</b>		
<b>Datë _____</b>		

	<p><b>Shtojca 2.</b></p> <p><b>Loti 2:</b> “Shërbime për realizimin e eventit: “Gjenerata e Inovacionit”</p> <p style="text-align: center;"><i>(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)</i></p> <p style="text-align: center;"><b>LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT</b></p>
--	--

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE):

\_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t’u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (4 x 5X)</b>	
1	LED 4x3m	copë	1			
2	Strukturë Layer për Led Wall 4x4m	m2	16			
3	Stage 4x3m	m2	12			
4	Ndricimi (LED, parë indoor)	copë	20			

5	Shërbim DJ	person	1			
6	Mikser për DJ	copë	1			
7	Foltore e Branduar	copë	1			
8	Dekorimi Skena - karrige për jurinë	copë	5			
9	Dekorim Skena - karrige të larta	copë	2			
10	Dekorimi Skena - tavolina për jurinë për 5 veta	copë	1			
11	Banake Regjistrimi, të branduar	copë	1			
12	Dekorimi - karrige të ulëta	copë	100			
13	Sistemi Audio i Brendshëm	sistem	1			
14	Photo Booth / rolling booth	copë	1			
15	Qera Hapësirë (Zona kryesore e eventit + një zone pushimi, kapaciteti: të paktën 120persona/ditë	ditë	2			
16	Karrige të ulëta/lounge për zona pushimi	copë	50			
17	Tavolina të ulëta për zonën e pushimit	copë	15			
18	Pufte dhe jastekë të rehatshëm	copë	20			
19	Shërbim Videografi	shërbim	1			
20	Shërbim Fotografi	shërbim	1			
21	Sistem Live Broadcasting	shërbim	1			
22	Roll up	copë	3			
23	Televizor me Rrota ose Mekanizëm	copë	1			

	Levizës					
24	Catering	100 persona/ditë	2			
25	Refreshments (kafe, uje, caj, biskota)	100 persona/ditë	2			
26	Trofe / Cmimi i personalizuar për fituesit	copë	5			
27	Bllok format A5 cover me karton 300gr i printuar sipas design, letra e brendshme me viza	copë	100			
28	Stilolapsa të branduar	copë	100			
29	Dosje të branduar	copë	100			
30	Moderator	person	1			
31	Ekspert të jashtëm	person	5			
		<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>						
<b>TVSH (%)</b>						
<b>Çmimi total me TVSH:</b>						
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>						
<b>Nënshkrimi</b>						
<b>Vula</b>						
<b>Datë</b> _____						



---

### Shtojca 3.

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik* ]

[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / *Nr. Referencës në faqen e APP-se*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [ emri i ofertuesit të siguruar ] ka derdhur një depozitë pranë [ emri dhe adresa e bankës ] / është garantuar pranë [ emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit ] me një vlerë prej [ monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra ] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit/entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të

---

klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

**Shtojca 5.**

(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ..... është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Loti 1: “Shërbime për realizimin e eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”

##### LED 4x3m (me qera)

- Madhësia e Modullit të panelit: 50 cm x 100 cm.
- Rezolucioni Pixel Pitch: 3.9 mm, panel i përshtatshëm për shfaqje me cilësi të lartë të imazhit edhe nga afër.
- Modul i përbërë nga LED të ndritshme.
- Ndriçimi duhet të jetë nga 1000 deri në 5000 cd/m<sup>2</sup> ose më shumë, varësisht nëse përdoret për ambiente të brendshme ose të jashtme.
- Kontrast i lartë për shfaqje më të qarta dhe të gjalla.
- Për të siguruar që imazhet të jenë të dukshme nga shumë kënde të ndryshme, duhet kënd shikimi afro 140° horizontal dhe vertikal,.
- Materialet e përdorura duhet të jenë rezistente ndaj kushteve të motit, pluhurit dhe ujit, zakonisht me klasifikim IP65 për përdorim në ambiente të jashtme.
- Dizajn modular për instalim të thjeshtë dhe mirëmbajtje të lehtë.
- Mund të ketë një dizajn të lehtë për t'u transportuar dhe instaluar në vende të ndryshme.
- Mundësi për të lidhur module të shumta për të krijuar një ekran më të madh, i cili menaxhohet nga një program qendror.
- Lidhje për Input Video: Porta HDMI, DVI, VGA, ose lidhje wireless për menaxhim të përmbajtjes video.
- Mundësi për Sinkronizim të Përmbajtjes: Për transmetim të vazhdueshëm të videos ose të imazheve nga burime të jashtme.
- LED-i të ketë mundësi shfaqjeje të mesazheve promovuese, videove dhe imazheve të tjera për audienca të mëdha.
- Përdorimi për qëllime të ngjashme, edhe në ambiente të brendshme, por me kërkesa më të ulëta për ndriçim.

##### 2. Strukturë Layer për 2 Led Wall 4x4m (me qera)

- Dimensionet e LED Wall: 4x4m(16m<sup>2</sup>)
- Sasia: 2 copë x 16m<sup>2</sup>
- Strukturat të përbëra nga pjesë modulare që mund të montohen/çmontohen lehtë, për të siguruar qëndrueshmëri.
- Material i fortë dhe rezistent i përforcuar për të siguruar qëndrueshmëri dhe peshë të lehtë për montim të shpejtë.

- Projektuar për të mbajtur peshën e ekraneve LED pa deformim apo rrezik për rrëzim, që suportojnë mbajtjen e një LED me përmasa 4x4m dhe sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
- Kornizë me përforcime diagonale për të ruajtur qëndrueshmërinë e strukturës.
- Struktura e bazës duhet të jetë mjaft e gjerë për të mos lejuar lëkundjen e ekranit gjatë përdorimit në vende me shumë njerëz ose kur paraqitet erë e fortë.
- Vida dhe shina speciale për të mbajtur panelet LED në vendin e duhur dhe për të mos lejuar lëvizjen e tyre.
- Dizajn modular për të lehtësuar paketimin, transportimin dhe montimin/çmontimin në vendndodhje të ndryshme.
- Duhet të përdoren sisteme mbërthimi që mund të montohen dhe çmontohen shpejt për efikasitet maksimal.
- Duhet të kenë kanale ose shina të dedikuara për të fshehur dhe mbrojtur kabllot elektrike dhe/ose të tjera, duke siguruar një pamje të pastër dhe të organizuar.
- Strukturat Layer duhet të jenë të përshtatura për evente të jashtme/të brendshme

### **3. Stage 8x3m (me qera)**

- Modulet të jenë afërsisht me keto përmasa 1x2m dhe të jenë të lehtë për lëvizje, montim/çmontim dhe transport.
- Këmbët të jenë të ndërtuara nga çeliku, inoxi, alumini ose material i ngjashëm për qëndrueshmëri dhe rezistencë.
- Mund të përbëhet nga dru i përforcuar, plastikë e qëndrueshme, ose materiale kompozite që rezistojnë ndaj konsumimit dhe gërvishtjeve.
- Të disponohen në madhësi të ndryshme, zakonisht nga 90 cm deri në 150 cm, për t'iu përshtatur nevojave të ndryshme të prezantuesve ose folësve.
- Lartësi të rregullueshme për t'iu përshtatur situatave të ndryshme dhe për të përmbushur preferencat personale të përdoruesve.
- Këmbët duhet të jenë të dizajnuara për të siguruar stabilitet, duke parandaluar lëkundjet ose rrëzimet gjatë përdorimit.
- Ideale për konferenca, organizime publike, leksione, seminare dhe organizime të ndryshme.
- Të garantojë qëndrueshmëri në sipërfaqe të ndryshme dhe për të parandaluar rrëshqitjen.

### **4. Dekorimi – tavolina të larta (me qera)**

- Tavolina me lartësi rreth 110 cm, për ambiente të hapura ose pritje ku njerëzit qëndrojnë në këmbë ose përdorin stola të lartë.
- Sipërfaqja me diametër afro 60 cm ose katrore, për të krijuar hapësirë të mjaftueshme për pije dhe pjata të vogla.
- Struktura metalike e qëndrueshme për këmbët, e përbërë nga çelik i fortë, alumini ose material i ngjashëm, për stabilitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

### **5. Dekorimi – mbulesa të zeza material i plotë (me qera)**

- Material poliester, pamuk të trashë ose material të ngjashëm dhe të qëndrueshëm për një mbulim të plotë dhe uniform, që ofron një pamje elegante dhe rezistencë ndaj rrudhave.

- Mbulesat duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar plotësisht tavolinat e larta.
- Materiali duhet të jetë me ngjyrë të zezë të thellë dhe/ose mat për një pamje elegante dhe për të minimizuar pasqyrimin e dritës.

## 6. Ndricimi (Led, pare indoor) (dritë e bardhë mediatike, ndricues wash rgb, ndriçues spot)(me qera)

### Dritë e Bardhë Mediatike (White Media Light)

- Dritë LED e bardhë për përdorim indoor, ideale për prezantime ose ndriçim të përgjithshëm në ambiente të brendshme.
- Rreth 5600K (dritë e bardhë e ftohtë) ose 3200K (dritë e bardhë e ngrohtë), me mundësi të rregullimit të temperaturës së ngjyrës për të përshtatur ambientin.
- Intensiteti i Ndricimit: Rreth 800 - 1500 Lux në distancë prej 1 metër.
- Këndi i Rrezes: 40° - 60° për ndriçim më të gjerë dhe të njëtrajtshëm.
- Fuqia: 50W - 150W varësisht nga madhësia dhe fuqia e ndriçuesit.
- Dimmer: Rregullim gradual i intensitetit nga 0% deri në 100%.

### Ndriçues Wash RGB

- Wash Light LED RGB për ndriçim me ngjyra, përdorur për evente, skena, ambiente të brendshme dhe shfaqje artistike.
- Përzierje e plotë RGB (e kuqe, jeshile, blu) për të krijuar një gamë të gjerë ngjyrash.
- Fuqia e Ndriçuesit: 100W - 300W, varësisht nga madhësia dhe intensiteti.
- Intensiteti i Ndricimit: 1000 - 3000 Lux në distancë prej 1 metër.
- Këndi i Rrezes: 30°-45°, duke krijuar një efekt të përhapur të dritës për të ndriçuar një hapësirë më të madhe.
- Kontroller ndriçuesi për kontroll të saktë të ngjyrave dhe intensitetit përmes protokollit të kontrollit të ndriçimit.
- Dimmer gradual dhe efekt strobe me frekuencë të rregullueshme.

### Ndriçues Spot (Spot Light)

- Spotlight, përdorur për ndriçim të fokusuar në skena, muze, ekspozita dhe/ose për të theksuar objekte specifike gjatë eventit.
- Temperatura e ngjyrës duhet të jetë e bardhë e ngrohtë (3000K), e bardhë natyrale (4000K) ose e bardhë e ftohtë (5600K).
- Fuqia e Ndriçuesit: 50W - 200W, varësisht nga fuqia e kërkuar.
- Këndi i Rrezes: 15° - 30° për një rreze më të ngushtë dhe të fokusuar.
- Intensiteti i Ndricimit: 2000 - 5000 Lux në distancë prej 1 metër.
- Dimmer për rregullim të intensitetit të dritës dhe mundësi për efekte të ndryshme ndriçimi.
- Mundësi për të krijuar ngjyra dhe efekte speciale përmes filtrave ose lenteve shtesë.
- Dizajn i Kompakt dhe i Lehtë: Lehtësi në montim/çmontim dhe transport.
- Kompatibilitet me sisteme të ndryshme kontrolli për funksionalitet të avancuar.
- Sisteme ftohjeje për të mbajtur temperaturën optimale të ndriçuesit.

## 7. Shërbim Dj (Dj Set)

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë muzikë të drejtpërdrejtë (Shërbimi i DJ) dhe argëtim për të gjithë pjesëmarrësit, duke krijuar një atmosferë energjike dhe të paharrueshme. DJ profesional do të përshtatë muzikën në përputhje me temën dhe

---

preferencat e audiencës, duke siguruar një gamë të gjerë stilesh muzikore, nga hitet më të fundit deri te klasiket.

- Përveç muzikës, DJ do të menaxhojë edhe aspektet teknike të audios, duke përdorur pajisje cilësore për të garantuar një tingull të shkëlqyer, shërbim i cili do të ndihmojë në rritjen e angazhimit dhe atmosferës festive gjatë eventit.

## **8. Ekuipazhi i skenave dhe zërit (tekniket e zërit, teknikët e ndriçimit)**

Tekniket Audio do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen e pajisjeve teknike si mëposhtë:

- Mikrofona: Dinamikë/kondensatorë, 20 Hz - 20 kHz
- Miksuesit: 8-32 kanale, XLR/TRS input/output
- Spekët: 100W - 2000W, 40 Hz - 20 kHz, 4Ω - 8Ω

Tekniket e ndriçimit do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen e pajisjeve teknike si mëposhtë:

- Dritat LED: PAR, Spot, Wash, 30W - 200W
- Kontrollerët: DMX512/të ngjashëm, 192 - 512 kanale
- Efektet: Fog Machine, 1-5 litra; Strobe, deri në 20 blende/sekondë

## **9. Qera Mikser për DJ**

- Mikseri të ketë ekran me dimensione të përafërta 9 inç dhe të jete me prekje.
- Porta USB dhe LAN për sinkronizim me pajisje të tjera dhe lidhje me kompjuter.
- Dalje Audio: Analog dhe koaksial digital për cilësi të lartë (24-bit/96kHz).
- Të suportojë dhe të luajë formatet: MP3, WAV, FLAC, ALAC.
- Hot Cues dhe Looping: hot cues, looping dhe funksione Quantize për miksim që ndrohe/ndihen lehtësisht.
- Sinkronizim i plotë me rekordbox për menaxhimin e bibliotekës audio dhe përgatitjen e setit.
- Të ketë ndërtim të qëndrueshëm dhe me këmbë anti-rrëshqitëse për stabilitet.

## **10. Prodhim Skenografi**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim e të gjithë skenës dhe elementëve të saj
- Skemë e ngritur në 3D, prodhim me materiale të ndryshme si fibër MDF/melamine/forex dhe/ose materiale kompozite me trashësi të ndryshme, adeviz matt, banera, telajo druri/hekuri me trashësi të ndryshme, struktura metalike me lartësi dhe trashësi të ndryshme, sipas konstruksioneve metalike të vetë-qendrushme dhe elementë të tjerë të nevojshëm për prodhimin e skenës.

## **11. Foltore e Branduar (me qera)**

- Dizajni i foltores që do ofrohet të jetë modern dhe funksional, me ngjyra që përkojnë me identitetin vizual të eventit, duke siguruar që logoja të jetë e dukshme dhe identifikuese.
- Foltoreja do të ketë përmasa për të ofruar hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e materialeve dhe pajisjeve. Sipërfaqja ballore do të jetë e branduar me logon e eventit.



---

## **12. Dekorimi Skena - kolltuqe velvet (me qera)**

- Kolltuqet e ofruara duhet të jenë të bëra nga velvet i cilësisë së lartë, duke ofruar një pamje luksoze dhe një ndjesi të butë për përdoruesit. Dizajni do të jetë modern dhe elegant, me ngjyra të ndryshme, si të kuqe, blu, dhe/ose ngjyra pastel, për të përshtatur estetikën e skenës dhe eventit.
- Strukturat do të jenë të forta dhe të qëndrueshme, të ndërtuara nga druri i fortë, metal i lehtë, dhe/ose materiale të ngjashme, të lehta për t'u transportuar.
- Kolltuqet do të jenë të përshtatshme për përdorim në skena për konferenca, ekspozita, dhe evente të tjera, duke krijuar një ambient komod dhe tërheqës për audiencën.

## **13. Dekorim Skena - karrige të larta (me qera)**

- Karriget do të jenë të ndërtuara nga materiale cilësore, si druri, metali, plastika rezistente dhe/ose materiale të ngjashme, duke ofruar qëndrueshmëri dhe estetikë. Ato do të kenë një dizajn modern dhe tërheqës, me ngjyra të ndryshme për t'u përshtatur me identitetin vizual të eventit.
- Ato do të jenë ideale për përdorim në këtë event, duke krijuar një ambient komod për folësit dhe audiencën.

## **14. Dekorimi Skena - tavolina të vogla plexiglass transparente 40x40cm (me qera)**

- Tavolinat do të jenë të ndërtuara nga plexiglass transparent, duke ofruar një pamje moderne dhe elegante, si edhe lehtësinë e përdorimit. Me përmasa afërsisht 40x40 cm, duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e aksesorëve, pijeve dhe/ose materialeve promovuese.
- Dizajni i tavolinave duhet të jetë minimalistik, duke u përshtatur me stilin e skenës, me struktura të forta dhe të qëndrueshme, me mundësi për të mbështetur peshë të moderuar pa u deformuar.

## **15. Banakë Rregjistrimi, të branduar (me qera)**

- Sipërfaqja e banakut do të jetë e branduar me logon e eventit dhe/ose elementë grafikë për të rritur dukshmërinë dhe identitetin e këtij eventi.

## **16. Dekorimi - karrige të ulëta transparente**

- Karriget do të jenë të ndërtuara nga materiale të tejdukshme si plexiglass ose polikarbonati, me dizajn minimalist.

## **17. Infopoint Corner/Media Booth (një hapësirë e branduar akomoduese dhe e pajisur me materiale dixhitale dhe interaktive)**

- Infopoint Corner do të ketë një strukturë të qëndrueshme dhe modulare, e ndërtuar nga materiale cilësore si MDF, druri, metalike dhe ose materiale të ngjashëm. Sipërfaqet komunikuese të booth-it duhet të jenë të branduar me logon dhe/ose elementët grafikët përkatës, duke rritur dukshmërinë e eventit dhe duke krijuar një identitet vizual tërheqës.
- Hapësira do të përfshijë elemente të pajisura me materiale dixhitale të aplikuara në ekrane LED ose LCD për shfaqjen e informacioneve, videove dhe/ose grafikëve interaktivë. Kjo do të ofrojë një eksperiencë të angazhuar për vizitorët, duke i lejuar ata të mësojnë më shumë rreth eventit dhe/ose produkteve/shërbimeve të agjencisë.
- Booth-i do të përfshijë gjithashtu, hapësirë për broshura, materiale promociionale dhe të tjera, për të angazhuar vizitorët në një mënyrë inovative.

### **18. Infopoint Corner/Media Booth me Tavolinë Interaktive (Qira për Dy Ditë)**

- Zona interaktive do të jetë e pajisur me ekran të ndjeshëm në prekje, duke ofruar mundësi për eksplorimin e informacionit dhe angazhim të vizitorëve përmes përmbajtjeve multimediale, inovative dhe interaktive.
- Gjatë qirasë dy ditore do të përfshihet instalim dhe mbështetje teknike.

### **19. Sistemi Audio i Brendshëm (skena me kapacitet 200 +) shërbim për dy ditë**

- Shërbim sistem audio i jashtëm/i brendshëm (Boks aktiv për fjalim, boks aktiv për muzikë, boks pasiv me vizualitet të ulët 16.5x16.5cm kapaciteti 100-300 persona)
- Boks aktiv për fjalim, me fuqi: 200W-400W dhe frekuencë: 60 Hz-18 kHz, të pajisura me Mikrofon XLR input, pjesë të integruara për EQ dhe kontrolle të zërit, për përdorim të lehtë dhe të shpejtë.
- Boks aktiv për muzikë me fuqi: 400-800W dhe frekuencë: 50 Hz-20 kHz, të pajisur me Input për instrumente dhe mikrofonta, EQ të avancuar për optimizimin e zërit dhe mundësi për lidhje me Bluetooth ose USB.
- Boks pasiv me fuqi: 200-300W dhe frekuencë: 40 Hz-20 kHz, të lidhur me një amplifikator të jashtëm, me mundësi për montim në mur ose në sipërfaqe të tjera sipas kërkesës së AK-së.

### **20. Stenda Interaktive Panairi (koncept panairi teknologjie të pajisur me ekrane interaktive, porta elektrike dhe sistem monitorimi)**

- Stenda duhet të jetë një koncept tërheqës për eventin, ajo do të jetë e pajisur me ekrane interaktive, që lejojnë vizitorët të eksplorojnë përmbajtjet multimediale interaktive dhe të angazhohen në mënyra inovative.

### **21. Qera Hapësire Multidimensionale, me mundësi akomodimi për skena dhe evente paralele, si dhe hapësirë për panairë teknologjie, për të akomoduar në lëvizje dhe hapësira të paktën 500 persona.**

- Hapësira multidimensionale duhet të ofrojë mundësi akomodimi për skena paralele, duke siguruar fleksibilitet për organizimin e ngjarjeve të teknologjisë dhe aktiviteteve të tjera. E përshtatshme për të akomoduar të paktën 500 persona në lëvizje, kjo hapësirë do

---

të krijojë një ambient të përshtatshëm për ndarje informacioni dhe angazhim me audiencën.

- Hapësira do të ketë zona të ndara për prezantime, interaktivitet dhe ekspozita, duke ofruar mundësi për përmirësimin e përvojës së vizitorëve. Ajo do të jetë e pajisur me ndriçim dhe pajisje moderne për të garantuar një atmosferë funksionale dhe tërheqëse.

## **22. Zhvillimi i Brandbook për Eventin**

- Brandbook-u për eventin do të përfshijë udhëzime të detajuara për konceptimin dhe krijimin e identitetit vizual dhe komunikimin e tij. Ai do të përfshijë logon e eventit, paletat e ngjyrave dhe fontet e përdorura, rregullat e përdorimit si edhe dizajnin e disa produkteve identifikuese të cilat do të jenë të përdorura në të gjitha materialet promovionale, si postera, broshura dhe platforma dixhitale. Rregullorja/Udhëzuesi do të përmbajë informacion mbi përdorimin e versioneve të ndryshme të logos.

## **23. Shërbim Videografi/Montim 2 ditë**

- Shërbimi i videografisë duhet të ofrojë xhirim profesional gjatë eventit, duke përdorur pajisje të avancuara për të siguruar cilësi të lartë. Ekipi i videografisë do të punojë ngushtë me autoritetin kontraktor për të kapur momentet kryesore dhe atmosferën e eventit, duke ofruar një rrëfim vizual të plotë dhe tërheqës.
- Montimi do të përfshijë përpunimin e materialeve të kapura, duke krijuar video të edituara që theksojnë momentet më të rëndësishme. Procesi i montimit do të përfshijë grafikën, muzikën dhe efektet vizuale për të përmirësuar përvojën e shikuesve/audiencës.
- Shërbimi do të përfshijë gjithashtu mundësinë e krijimit të videove promovionale dhe pas-eventit për të rritur dukshmërinë e eventit dhe për të angazhuar më tej audiencën. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që çdo xhirim të ruhet në mënyrë profesionale dhe të ndihmojë në ndarjen e përvojave me një audiencë më të gjerë përmes mediave sociale dhe platformave të tjera dixhitale, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor.
- Videografi duhet të garantojë përdorimin e kamerave DSLR, mirrorless ose profesioniste me rezolucion minimal 2K-4K dhe frame rate 30-60 fps, duke shfrytëzuar objektiva si 24-70mm f/2.8 dhe 70-200mm f/2.8, si dhe një objektiv të gjerë për pamje më të gjera. Ai gjithashtu nëse do të nevojiten duhet të përdorë aksesore si gimbal për stabilizim, mikrofon të jashtëm dhe dritat LED, dhe për editimin e materialeve, programet si Premiere Pro, Final Cut Pro dhe/ose të ngjashëm.
- Operatori ekonomik duhet të garantojë qëndrim diskret dhe profesional gjatë gjithë eventit për të mos ndërprerë rrjedhën e ngjarjeve dhe për të respektuar privatësinë e pjesëmarrësve dhe të ruhet anonimat i përdorimit të materialeve. Këto materiale do të konsiderohen pronë e AK-së dhe nuk do të përdoren apo tranferohen drejt palëve të tjera.

## **24. Shërbim Fotografi 2 ditë**

- Shërbimi i fotografisë do të ofrojë fotografimin profesional të momenteve gjatë eventit për dy ditë, duke siguruar që çdo aspekt i eventit të dokumentohet në mënyrë të saktë dhe artistike. Fotografët do të përdorin pajisje të avancuara për të garantuar cilësi të

---

lartë të imazheve, duke përfshirë kamera me rezolucion të lartë dhe objektiva të ndryshëm për të kapur detaje të hollësishme dhe pamje të gjera.

- Ky shërbim duhet të përfshijë një mbulim të plotë, duke përfshirë momentet kryesore, interaksionet e pjesëmarrësve dhe atmosferën e përgjithshme.
- Shërbimi i fotografisë do të jetë përgjegjës për përdorimin e pajisjeve teknike të avancuara, përfshirë kamera DSLR ose mirrorless me minimum 24 MP dhe sensor full-frame ose APS-C, objektiva 24-70mm f/2.8, 70-200mm f/2.8, dhe/ose një objektiv të gjerë 16-35mm. Gjithashtu nëse do të nevojiten do përdoren aksesorë si tripod, flashe të jashtme dhe filtra, si dhe program për editim si Lightroom, Photoshop dhe/ose të ngjashëm për të siguruar cilësi të lartë në çdo imazh.
- Operatori ekonomik duhet të garantojë qëndrim diskret dhe profesional gjatë gjithë eventit për të mos ndërprerë rrjedhën e ngjarjeve dhe për të respektuar privatësinë e pjesëmarrësve dhe të ruhet anonimati i përdorimit të materialeve. Këto materiale do të konsiderohen pronë e AK-së dhe nuk do të përdoren apo tranferohen drejt palëve të tjera.

## **25. Spote Promovuese 30 Sekondëshe**

- Spotet promovuese duhet të jenë të dizajnuara për të tërhequr vëmendjen e audiencës me kohëzgjatje rreth 30 sekonda, duke shfrytëzuar imazhe tërheqëse dhe mesazhe të qarta për të promovuar eventin. Ato do të përfshijnë elemente vizuale dinamike, të bukur, të ngrohtë, inovative dhe interaktiv.
- Përdorimi i muzikave motivuese dhe zërave narrativë do të krijojnë një atmosferë emocionuese, duke inkurajuar shikuesit të informohen për këtë event/ngjarje. Spotet do të jenë të optimizuara/përshtatura për platforma të ndryshme, si media sociale dhe televizion, për të garantuar një arritje maksimale të audiencës dhe promovimin efektiv të eventit.

## **26. Shërbim Regjie dhe Skenografie**

- Shërbimi i regjisë dhe skenografisë duhet të ofrojë planifikimin dhe realizimin e aspektit vizual dhe artistik të ngjarjeve. Ekipi i regjisë do të koordinojë çdo detaj të performancës, duke siguruar që skenari të zbatohet në mënyrë të përsosur dhe që të gjithë pjesëmarrësit të kenë një udhëzim të qartë për lëvizjet dhe veprimet e tyre.
- Skenografia do të përfshijë dizajnin e hapësirës skenike, duke përdorur materiale të ndryshme për të krijuar një ambient tërheqës dhe funksional, i përshtatur për eventin. Nëse do ketë kjo do të përfshijë dekorin, ndriçimin, dhe elementët e tjerë vizualë që do të kontribuojnë në atmosferën e përgjithshme.
- Shërbimi i regjisë do të jetë përgjegjës për përdorimin e pajisjeve teknike të avancuara, përfshirë monitorë të shumtë, kontrollues videosh dhe audiosh, si dhe programe për menaxhimin e drejtpërdrejtë, miksera dhe monitorë audio për kontrollin në kohë reale, së bashku me një sistem komunikimi gjithëpërfshirës për koordinimin efikas të eventit.

## **27. Zhvillim Aplikacioni për Menaxhim Eventit, me veçori si regjistrimi i përdoruesve, faqet e personalizuar të eventit dhe axhendes, biletat, njoftimet, mjetet e angazhimit të pjesëmarrësve, analitika në kohë reale, listimet e ekspozuesve/sponsorëve, përvojat AR, pagesa të sigurta dhe mbështetje shumëgjuhëshe**

- Aplikacioni për menaxhimin e eventeve do të ofrojë një platformë të plotë me veçori si regjistrimi i përdoruesve, faqet e personalizuar të eventeve, menaxhimi i biletave dhe njoftimeve, si dhe mjetet e angazhimit të pjesëmarrësve. Ai do të sigurojë analitika në kohë reale, listimet, përvojat, pagesa të sigurta dhe mbështetje shumëgjuhëshe për përdoruesit.
- Programi gjithashtu duhet të ofrojë zgjidhje të avancuara për planifikimin dhe menaxhimin e eventeve, duke lehtësuar organizimin dhe komunikimin me pjesëmarrësit. Kjo platformë duhet të ndihmojë në optimizimin e procesit të menaxhimit dhe në rritjen e angazhimit të audiencës.

## **28. Speech to text AI Specifikim: Transkriptim live shqip dhe anglisht dhe shfaqja e tyre në stream**

- Shërbimi i transkriptimit live do të ofrojë konvertimin e fjalëve në tekst në kohë reale në gjuhët shqip dhe anglisht, me shfaqjen e tekstit të transkriptuar në transmetimet live. Ky sistem do të sigurojë saktësi të lartë dhe do të lejojë shikuesit të ndjekin më lehtë zhvillimin e eventit. Për më tepër, shërbimi do të mbështesë përmirësimin, saktësinë e transkriptimit, duke rritur aksesin dhe angazhimin e audiencës gjatë ngjarjeve.

## **29. Televizorë me Rrota ose Mekanizëm Lëvizës**

- Ekran interaktiv/televizor i madhësive 32"-75", i vetëqendrushëm
- Rezolucioni: Full HD (1920x1080) ose 4K Ultra HD për cilësi të lartë imazhi.
- Teknologjia e prekjes: Infra të kuqe ose kapacitiv me shumë pika prekje (multi-touch) për interaktivitet të lehtë.
- Përfshirja e Anti-glare: Për t'i bërë ekranet më të lexueshme në ambiente me ndriçim të lartë.
- Sistemi operativ: Android i integruar dhe mundësi për lidhje me pajisje Windows apo macOS.
- Aplikacione të parainstaluara: Për menaxhim të prezantimeve, shkrim dore, dhe mësim.
- Porta HDMI, VGA, USB: Për lidhje me pajisje të jashtme si laptopë, kamera, etj.
- Wi-Fi dhe Bluetooth: Për lidhje wireless me pajisje dhe rrjet.
- Ethernet LAN: Për lidhje të qëndrueshme interneti.
- USB-C: Për lidhje të shpejtë dhe furnizim energjie për pajisje të tjera.
- Bokse të integruara: Minimumi 2x10W për cilësi të mirë audioje në dhomat e mëdha.
- Mikrofona: Për funksionet e konferencave ose regjistrimit të zërit.
- Dizajn i vetëqendrushëm: Konstruksion i qëndrueshëm që lejon të vendoset në çdo hapësirë pa nevojë për montim në mur.
- Rrota të lëvizshme: Për lëvizje të lehtë dhe fleksibilitet.
- Rregullim i lartësisë: Mundësi për ngritje/ulje të ekranit për të lehtësuar përdorimin nga përdorues të ndryshëm.
- Prezantime pa kablllo: Lidhje wireless me pajisje të ndryshme për ndarjen e ekranit.
- Stylus për prekje dhe shkrim: Lapsa të posaçëm për shkrim dore në ekran.
- Kamerë e integruar: Për konferenca online dhe video-thirrje.

## **30. Shërbim për optimizimin e SEO/Google**

- 
- Shërbimi i optimizimit për motorët e kërkimit (SEO) do të fokusohet në rritjen e dukshmërisë dhe renditjes së eventit në rezultatet e kërkimit të Google. Ai përfshin analizën e fjalëve kyçe, optimizimin e përmbajtjes dhe elementeve on-page, si dhe monitorimin e performancës përmes mjeteve si Google Analytics. Ky shërbim do të ndihmojë në rritjen e trafikut organik dhe përmirësimin e pozicionit tuaj në rezultatet e kërkimit, duke rritur kështu angazhimin e audiencës.

### **31. Shërbim Master of Ceremony**

- Shërbimi i Master of Ceremony (MC) duhet të ofrojë një udhëheqës profesional për eventin, duke siguruar një rrjedhë të qartë dhe dinamike të ngjarjes. MC do të jetë përgjegjës për prezantimin e folësve, menaxhimin e kalendarit të aktiviteteve dhe angazhimin e audiencës, për të krijuar një atmosferë të këndshme dhe emocionuese.
- MC do të lidhet me pjesëmarrësit dhe do të ndihmojë në ruajtjen e energjisë, gjallërisë gjatë gjithë eventit. Ai do të sigurojë që të gjitha aktivitetet të ndodhin në mënyrë të sinkronizuar, duke kontribuar në suksesin e përgjithshëm të ngjarjes dhe përvojës së pjesëmarrësve.

### **32. Tarifa për Folësit nga Ballkani**

- Operatori ekonomik duhet të garantojë pjesëmarrjen në event, akomodimin, transportin dhe minimumi dy vakte ushqimi/dite për folësit nga Ballkani. Perzgjedhja do të behet nga AK.

### **33. Tarifa për folësit nga Europa**

- Operatori ekonomik duhet të garantojë pjesëmarrjen në event, akomodimin, transportin dhe minimumi dy vakte ushqimi/dite për folësit nga Europa. Perzgjedhja do të behet nga AK.

### **34. Tarifa për folësit nga Amerika/Australi/Azi/Afrikë**

- Operatori ekonomik duhet të garantojë pjesëmarrjen në event, akomodimin, transportin dhe minimumi dy vakte ushqimi/dite për folësit nga Amerika/Australi/Azi/Afrike. Perzgjedhja do të behet nga AK.

### **35. Pritje me Koktail dhe Catering**

- Shërbimi i pritjes duhet të ofrojë një përvojë të veçantë për 150 persona për ditën e parë të eventit, me koktejl dhe një menu të larmishme që përfshin “fingerfood” dhe ëmbëlsira. Operatori ekonomik duhet të ketë një ekip profesionistësh dhe do të sigurojë shërbim të shkëlqyer dhe një atmosferë miqësore.

### **36. Lunch boxes**

- Shërbimi i drekës duhet të ofrojë zgjidhje praktike dhe të shijshme për 250 persona/dite. Një menu e pasur me finger food, përfshin një përzierje të ushqimeve të ftohta dhe të ngrohta. Në pjesën e të ftohtave, mund të shërbeni kanape të ndryshme me proshutë, sallam, salmon të tymosur dhe vezë, të shoqëruara me rolada tortilla me mbushje të larmishme dhe antipasta me qofte djathi, ullinj të marinuar dhe kombinime domate-mocarella. Për ushqimet e ngrohta, mini byreket tradicionale me spinaq, djathë dhe mish janë gjithmonë të mirëpritura, së bashku me qofte të vogla, pulë në shish dhe mini hamburger. Për miqtë vegjetarianë, përfshini kroketa me patate, kërpudha të mbushura dhe spring rolls me perime. Në fund, për të ëmbëlsuar gojën, shërbeni profiterole, petit four, mini tiramisu në gota dhe makaron në ngjyra të ndryshme. Kjo përzgjedhje ofron diçka për çdo shije dhe është perfekte për çdo lloj event.

### **37. Refreshments (kafe, ujë, çaj)**

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbim me një gamë të larmishme pijesh për eventin, duke përfshirë kafe, çaj dhe ujë për 250 persona/dite. Ky shërbim do të sigurojë hidratimin dhe relaksim e mysafirëve, duke kontribuar në një atmosferë të këndshme gjatë aktivitetit.

### **38. Totebags të Branduar (Çanta të ripërdorshme të branduara)**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim.
- Materiali të jetë ekologjik dhe i qëndrueshëm, si pambuku/kanavaca që janë të forta, natyrale dhe të lehta për t'u larë, ose jutën që është miqësore për mjedisin dhe e biodegradueshme. Gjithashtu i preferueshëm është edhe materiali polipropilenit i qëndrueshëm dhe që përdoret për promovime. Materiali të ketë peshë/trashësi të mjaftueshme për të përballuar peshën, dhe përmasat të jenë afërsisht 40cm gjatësi, 35cm lartësi dhe 8cm thellësi.
- Gjatësia e dorezave duhet të përshtatet me stilin e mbajtjes (me dorë ose mbi supë) dhe materiali i tyre duhet të përputhet me atë të çantës ose të jetë më i fortë.
- Printimi/brandimi/logoja mund të vendoset përpara, mbrapa ose në të dyja anët e çantës, me teknikë printimi si "screenprinting", tampografi, serigrafji apo printim digjital. Ngjyrat e printimit duhet të kenë kontrast të mirë me çantën dhe të jenë në përputhje me brandin.
- Përdorni udhëzimet e brandbook-ut të logos për zgjedhjen e ngjyrave dhe sigurohuni që madhësia e logos të jetë proporcionale me çantën.
- Kërkohet përdorimi i bojërave miqësore për mjedisin, si ato me bazë uji ose soje, dhe sigurohuni që materialet të jenë të certifikuar si organike.

### **39. Badges**

- Materiali të jetë plastikë e fortë PVC ose i ngjashëm.
- Madhësitë standarde ose të përafërta janë 10x7cm ose 9x6cm për lehtësi leximi dhe hapësirë për informacione të personelit të eventit ose sipas kërkesës së AK-së.
- Printim me cilësi të lartë për grafikën, logon dhe tekstin, duke përdorur teknika si printimi digjital për ngjyra dhe detaje të qarta.

- Rripi i qafës të jetë material najlon, poliestër ose i ngjashëm për qëndrueshmëri dhe komoditet, me gjerësi 1-2 cm. Mund të personalizohet me logon e eventit.
- Materiale rekomandohen të jenë të riciklueshme dhe bojërat e përdorura të jenë me bazë uji për të reduktuar ndikimin mjedisor.

#### **40. Bllok format A5 cover me karton 300gr i printuar me design, letra e brendshme pa viza**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim
- Format: A5 (14.8 cm x 21 cm ose i përafërt), kompakt dhe i lehtë për t'u mbajtur në çantë dhe/ose në dorë.
- Kapaku të jetë karton i trashë afro 300gr./m<sup>2</sup>, i dizenuar dhe i printuar. Printimi duhet të jetë me cilësi të lartë për të ruajtur detajet e dizajnit dhe ngjyrat.
- Brendia: Letër e bardhë offset, me peshë 70-80gr./m<sup>2</sup> me sipërfaqe të lëmuar, të përshtatshme për shkrim me stilolaps, laps ose marker.
- Numri i fletëve: Rreth 50 fletë.
- Libërlidhja: Spirale metalike ose ngjitje në anën e sipërme/anësore për lehtësi në hapje dhe përdorim.

#### **41. Stilolapsa të branduar**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim
- Materiali: Eco-plastic
- Printimi/logimi: sipas udhëzuesit të logos duke përdorur teknikat e printimit me bojra UV

#### **42. Roll ups 85x200 cm**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim
- Format: 85x200 cm
- Printimi: Baner me bojra ekologjike dhe me rezolucion të lartë për ambiente të brendshme
- Mekanizmi aluminit dhe çanta të përfshira: Po
- Materiale rekomandohen të jenë të riciklueshme dhe bojërat e përdorura të jenë me bazë uji për të reduktuar ndikimin mjedisor.

#### **43. Shërbim montim/çmontim/transport - nevojiten burime për ngritjen e skenave të ndryshme, rregullimin e ulëseve ose/ose zonave të ekspozitës/panairit**

- Operatori ekonomik të sigurojë burimet e nevojshme për montim/çmontim si: punonjës për ngritjen dhe stabilizimin e strukturave të skenave, me përvojë në instalimin e ndriçimit dhe sistemeve të zërit, pajisjeve si shtylla metalike, platforma, skela dhe mjete të specializuara për siguri teknike dhe humane.
- Operatori ekonomik të sigurojë transportin e nevojshëm me kamionë dhe/ose furgona të pajisur për ngarkesë të rëndë, me ndarje të rregulluar për transportimin e materialeve pa dëmtime.



---

#### 44. Koordinim Eventi, gjatë ditëve në terren

- Operatori ekonomik duhet të sigurojë burimet e nevojshme për ekipin e koordinimit. Një grup menaxherësh dhe koordinatorësh me role të qarta për secilin aspekt të eventit (logjistikë, pritja e pjesëmarrësve, teknologji, sigurim), të cilët mund të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin vendime të shpejta.
- Operatori ekonomik të punojë ngushtësisht me autoritetin kontraktor për të konfirmuar orarin, axhendën dhe hartimin e një plani të detajuar ditor që përfshin aktivitetet, seancat, pushimet dhe çdo kohë të nevojshme për ngjarje. Ky plan duhet të shpërndahet tek i gjithë ekipi (OE dhe AK) për të siguruar që të gjithë janë të informuar për oraret dhe vendet ku duhet të jenë.
- Operatori ekonomik të sigurojë kontroll të vazhdueshëm të logjistikës, për të siguruar që gjithçka është në vend dhe funksionale, dhënien e informacionit, koordinimin i teknologjisë dhe ndriçimit.

#### 45. Pishtar zjarri i madh me diametër të paktën 1 metër

- Konstruksion metalik i fortë dhe i qëndrueshëm, prej çeliku të pandryshkshëm ose materiali tjetër, për të përballuar nxehtësinë e lartë dhe për të siguruar stabilitet. Struktura duhet të ketë një bazament të fortë që të mos lëvizë.
- Formë konike si shportë metalike e bërë nga çelik/hekur ose material i ngjashëm i trashë, me diametër të paktën 1 metër. Mbajtësja duhet të ketë vrima për ventilim, për të ndihmuar qarkullimin e ajrit dhe për të mbajtur zjarrin ndezur.
- Furnizimi të kryhet me karburant/gaz: Mund të përdoren drutë, karburant i ngurtë, ose një sistem gazi për ndezje të kontrolluar. Nëse përdoret gaz, nevojitet një rezervuar me valvulë kontrolli dhe tubacione të izoluar që të qëndrojnë larg flakës për të parandaluar rrezikun e shpërthimit.
- Operatori ekonomik të garantojë sigurinë që të ketë një “rreth mbrojtës” përreth bazës së pishtarit për të mbajtur distancën nga audienca dhe të ketë të vendosur aparate fikëse zjarri ose një burim uji pranë për raste emergjente.
- Struktura duhet të jetë modulare ose e çmontueshme për lehtësi në transport dhe montim/çmontim.

---

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Loti 2: “Shërbime për realizimin e eventit: “Gjenerata e Inovacionit”

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE PER EVENTIN “GJENERATA E INOVACIONIT”

##### 1. LED 4x3m (me qera)

- Madhësia e Modulit të panelit: 50 cm x 100 cm.
- Rezolucioni Pixel Pitch: 3.9 mm, panel i përshtatshëm për shfaqje me cilësi të lartë të imazhit edhe nga afër.
- Modul i përbërë nga LED të ndritshme.
- Ndriçimi duhet të jetë nga 1000 deri në 5000 cd/m<sup>2</sup> ose më shumë, varësisht nëse përdoret për ambiente të brendshme ose të jashtme.
- Kontrast i lartë për shfaqje më të qarta dhe të gjalla.
- Për të siguruar që imazhet të jenë të dukshme nga shumë kënde të ndryshme, duhet kënd shikimi afro 140° horizontal dhe vertikal,.
- Materialet e përdorura duhet të jenë rezistente ndaj kushteve të motit, pluhurit dhe ujit, zakonisht me klasifikim IP65 për përdorim në ambiente të jashtme.
- Dizajn modular për instalim të thjeshtë dhe mirëmbajtje të lehtë.
- Mund të ketë një dizajn të lehtë për t'u transportuar dhe instaluar në vende të ndryshme.
- Mundësi për të lidhur module të shumta për të krijuar një ekran më të madh, i cili menaxhohet nga një program qendror.
- Lidhje për Input Video: Porta HDMI, DVI, VGA, ose lidhje wireless për menaxhim të përmbajtjes video.
- Mundësi për Sinkronizim të Përmbajtjes: Për transmetim të vazhdueshëm të videos ose të imazheve nga burime të jashtme.
- LED-i të ketë mundësi shfaqjeje të mesazheve promovuese, videove dhe imazheve të tjera për audienca të mëdha.
- Përdorimi për qëllime të ngjashme, edhe në ambiente të brendshme, por me kërkesa më të ulëta për ndriçim.

##### 2. Strukturë Layer për Led Wall 4x4m -16m<sup>2</sup> (me qera)

- Dimensionet e LED Wall: 4x4m(16m<sup>2</sup>)
- Sasia: 1 copë x 16m<sup>2</sup>

- Strukturat të përbëra nga pjesë modulare që mund të montohen/çmontohen lehtë, për të siguruar qëndrueshmëri.
- Material i fortë dhe rezistent i përforcuar për të siguruar qëndrueshmëri dhe peshë të lehtë për montim të shpejtë.
- Projektuar për të mbajtur peshën e ekraneve LED pa deformim apo rrezik për rrëzim, që suportojnë mbajtjen e një LED me përmasa 4x4m dhe sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
- Kornizë me përforcime diagonale për të ruajtur qëndrueshmërinë e strukturës.
- Struktura e bazës duhet të jetë mjaft e gjerë për të mos lejuar lëkundjen e ekranit gjatë përdorimit në vende me shumë njerëz ose kur paraqitet erë e fortë.
- Vida dhe shina speciale për të mbajtur panelet LED në vendin e duhur dhe për të mos lejuar lëvizjen e tyre.
- Dizajn modular për të lehtësuar paketimin, transportimin dhe montimin/çmontimin në vendndodhje të ndryshme.
- Duhet të përdoren sisteme mbërthimi që mund të montohen dhe çmontohen shpejt për efikasitet maksimal.
- Duhet të kenë kanale ose shina të dedikuara për të fshehur dhe mbrojtur kabllot elektrike dhe/ose të tjera, duke siguruar një pamje të pastër dhe të organizuar.
- Strukturat Layer duhet të jenë të përshtatura për evente të jashtme/të brendshme

### 3. Stage 4x3m (me qera)

- Modulet të jenë afërsisht me keto përmasa 1x2m dhe të jenë të lehtë për lëvizje, montim/çmontim dhe transport.
- Këmbët të jenë të ndërtuara nga çeliku, inoxi, alumini ose material i ngjashëm për qëndrueshmëri dhe rezistencë.
- Mund të përbëhet nga dru i përforcuar, plastikë e qëndrueshme, ose materiale kompozite që rezistojnë ndaj konsumimit dhe gërvishjeve.
- Të disponohen në madhësi të ndryshme, zakonisht nga 90 cm deri në 150 cm, për t'iu përshtatur nevojave të ndryshme të prezantuesve ose folësve.
- Lartësi të rregullueshme për t'iu përshtatur situatave të ndryshme dhe për të përmbushur preferencat personale të përdoruesve.
- Këmbët duhet të jenë të dizajnuara për të siguruar stabilitet, duke parandaluar lëkundjet ose rrëzimet gjatë përdorimit.
- Ideale për konferenca, organizime publike, leksione, seminare dhe organizime të ndryshme.
- Të garantojë qëndrueshmëri në sipërfaqe të ndryshme dhe për të parandaluar rrëshqitjen.

### 4. Ndricimi (Led, pare indoor) (dritë e bardhë mediatike, ndricues wash rgb, ndricues spot)(me qera)

#### Dritë e Bardhë Mediatike (White Media Light)

- Dritë LED e bardhë për përdorim indoor, ideale për prezantime ose ndriçim të përgjithshëm në ambiente të brendshme.
- Rreth 5600K (dritë e bardhë e ftohtë) ose 3200K (dritë e bardhë e ngrohtë), me mundësi të rregullimit të temperaturës së ngjyrës për të përshtatur ambientin.
- Intensiteti i Ndricimit: Rreth 800 - 1500 Lux në distancë prej 1 metër.

- Këndi i Rrezes: 40° - 60° për ndriçim më të gjerë dhe të njëtrajtshëm.
- Fuqia: 50W - 150W varësisht nga madhësia dhe fuqia e ndriçuesit.
- Dimmer: Rregullim gradual i intensitetit nga 0% deri në 100%.

#### **Ndriçues Wash RGB**

- Wash Light LED RGB për ndriçim me ngjyra, përdorur për evente, skena, ambiente të brendshme dhe shfaqje artistike.
- Përzierje e plotë RGB (e kuqe, jeshile, blu) për të krijuar një gamë të gjerë ngjyrash.
- Fuqia e Ndriçuesit: 100W - 300W, varësisht nga madhësia dhe intensiteti.
- Intensiteti i Ndriçimit: 1000 - 3000 Lux në distancë prej 1 metër.
- Këndi i Rrezes: 30°-45°, duke krijuar një efekt të përhapur të dritës për të ndriçuar një hapësirë më të madhe.
- Kontroller ndriçuesi për kontroll të saktë të ngjyrave dhe intensitetit përmes protokollit të kontrollit të ndriçimit.
- Dimmer gradual dhe efekt strobe me frekuencë të rregullueshme.

#### **Ndriçues Spot (Spot Light)**

- Spotlight, përdorur për ndriçim të fokusuar në skena, muze, ekspozita dhe/ose për të theksuar objekte specifike gjatë eventit.
- Temperatura e ngjyrës duhet të jetë e bardhë e ngrohtë (3000K), e bardhë natyrale (4000K) ose e bardhë e ftohtë (5600K).
- Fuqia e Ndriçuesit: 50W - 200W, varësisht nga fuqia e kërkuar.
- Këndi i Rrezes: 15° - 30° për një rreze më të ngushtë dhe të fokusuar.
- Intensiteti i Ndriçimit: 2000 - 5000 Lux në distancë prej 1 metër.
- Dimmer për rregullim të intensitetit të dritës dhe mundësi për efekte të ndryshme ndriçimi.
- Mundësi për të krijuar ngjyra dhe efekte speciale përmes filtrave ose lenteve shtesë.
- Dizajn i Kompakt dhe i Lehtë: Lehtësi në montim/çmontim dhe transport.
- Kompatibilitet me sisteme të ndryshme kontrolli për funksionalitet të avancuar.
- Sisteme ftohjeje për të mbajtur temperaturën optimale të ndriçuesit.

### **5. Shërbim Dj (Dj Set)**

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë muzikë të drejtpërdrejtë (Shërbimi i DJ) dhe argëtim për të gjithë pjesëmarrësit, duke krijuar një atmosferë energjike dhe të paharrueshme. DJ profesional do të përshtatë muzikën në përputhje me temën dhe preferencat e audiencës, duke siguruar një gamë të gjerë stilesh muzikore, nga hitet më të fundit deri te klasiket.
- Përveç muzikës, DJ do të menaxhojë edhe aspektet teknike të audios, duke përdorur pajisje cilësore për të garantuar një tingull të shkëlqyer, shërbim i cili do të ndihmojë në rritjen e angazhimit dhe atmosferës festive gjatë eventit.

### **6. Mikser për DJ (me qera)**

- Mikseri të ketë ekran me dimensione të përafërta 9 inç dhe të jenë me prekje.
- Porta USB dhe LAN për sinkronizim me pajisje të tjera dhe lidhje me kompjuter.
- Dalje Audio: Analog dhe koaksial digjital për cilësi të lartë (24-bit/96kHz).
- Të suportojë dhe të luajë formatet: MP3, WAV, FLAC, ALAC.
- Hot Cues dhe Looping: hot cues, looping dhe funksione Quantize për miksim që ndrohe/ndihen lehtësisht.

- 
- Sinkronizim i plotë me rekordbox për menaxhimin e bibliotekës audio dhe përgatitjen e setit.
  - Të ketë ndërtim të qëndrueshëm dhe me këmbë anti-rrëshqitëse për stabilitet.

### **7. Foltore e Branduar (me qera)**

- Dizajni i foltores që do ofrohet të jetë modern dhe funksional, me ngjyra që përkojnë me identitetin vizual të eventit, duke siguruar që logoja të jetë e dukshme dhe identifikuese.
- Foltoreja do të ketë përmasa për të ofruar hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e materialeve dhe pajisjeve. Sipërfaqja ballore do të jetë e branduar me logon e eventit.

### **8. Dekorimi Skena – karrige per jurine (me qera)**

- Karriget e ofruara duhet të ofrojne një pamje luksoze dhe një ndjesi të butë për përdoruesit. Dizajni do të jetë modern dhe elegant, me ngjyra të ndryshme, si të kuqe, blu, dhe/ose ngjyra pastel, për të përshtatur estetikën e skenës dhe eventit.
- Strukturat do të jenë të forta dhe të qëndrueshme, të ndërtuara nga druri i fortë, metal i lehtë, dhe/ose materiale të ngjashme, të lehta për t'u transportuar.
- Karriget do të jenë të përshtatshme për përdorim në skena për konferenca, ekspozita, dhe evente të tjera, duke krijuar një ambient komod dhe tërheqës për audiencën.

### **9. Dekorim Skena - karrige të larta (me qera)**

- Karriget do të jenë të ndërtuara nga materiale cilësore, si druri, metali, plastika rezistente dhe/ose materiale të ngjashme, duke ofruar qëndrueshmëri dhe estetikë. Ato do të kenë një dizajn modern dhe tërheqës, me ngjyra të ndryshme për t'u përshtatur me identitetin vizual të eventit.
- Ato do të jenë ideale për përdorim në këtë event, duke krijuar një ambient komod për folësit dhe audiencën.

### **10. Dekorimi Skena - tavolina per jurine per 5 veta (me qera)**

- Tavolina e jurisë për pesë persona është projektuar për të ofruar një pamje profesionale dhe komoditet maksimal gjatë përdorimit në evente dhe konferenca. E ndërtuar nga dru cilësor ose MDF me finiturë premium që reziston ndaj gërvishtjeve dhe njollave, tavolina vjen në ngjyra neutrale si dru i errët, e zezë, apo e bardhë mat për të plotësuar estetikën e çdo skene.
- Dizajni i tavolinave duhet të jetë i përshtatshëm për evente, konferenca, duke u përshtatur me stilin e skenës, me struktura të forta dhe të qëndrueshme, me mundësi për të mbështetur peshë të moderuar pa u deformuar. Me një dizajn modern, në formë rektangulare dhe përmasa rreth 2.5 metra gjatësi dhe 1 metër gjerësi, ajo siguron hapësirë të bollshme për secilin anëtar të jurisë.

---

## **11. Banakë Rregjistrimi, të branduar (me qera)**

- Sipërfaqja e banakut do të jetë e branduar me logon e eventit dhe/ose elementë grafikë për të rritur dukshmërinë dhe identitetin e këtij eventit.

## **12. Dekorimi - karrige të ulëta per sallën kryesore te eventit (me qera)**

- Karriget do të jenë të pershtatshme per evente, ku te ulen pjesemarresit qe do te degjojne dhe do jene pjese e eventit, pra do te jene ne sallën kryesore ku do te behen dhe prezantimet.
- Dizajni do të jetë modern dhe estetik, me linja të pastra dhe forma ergonomike që sigurojnë rehati gjatë përdorimit.
- Karriget do të jenë të ndërtuara nga materiale të qëndrueshme si druri i fortë ose metal i lehtë, me një mbushje të butë për ulje komode.
- Disponueshmëria e ngjyrave do të përfshijë mundësi të ndryshme, si ngjyra neutrale (të tilla si gri, e bardhë, e zezë) dhe ngjyra më të gjalla (si të kuqe, blu, apo pastel) për të përputhur temën e eventit.

## **13. Sistemi Audio i Brendshëm (skena me kapacitet 90 +) shërbim për dy ditë**

- Shërbim sistem audio i jashtëm/i brendshëm (Boks aktiv për fjalim, boks aktiv për muzikë, boks pasiv me vizualitet të ulët 16.5x16.5cm kapaciteti 80-120 persona)
- Boks aktiv për fjalim, me fuqi: 200W-400W dhe frekuencë: 60 Hz-18 kHz, të pajisura me Mikrofon XLR input, pjesë të integruara për EQ dhe kontrolle të zërit, për përdorim të lehtë dhe të shpejtë.
- Boks aktiv për muzikë me fuqi: 400-800W dhe frekuencë: 50 Hz-20 kHz, të pajisur me Input për instrumente dhe mikrofone, EQ të avancuar për optimizimin e zërit dhe mundësi për lidhje me Bluetooth ose USB.
- Boks pasiv me fuqi: 200-300W dhe frekuencë: 40 Hz-20 kHz, të lidhur me një amplifikator të jashtëm, me mundësi për montim në mur ose në sipërfaqe të tjera sipas kërkesës së AK-së.

## **14. Photo Booth/ rolling booth**

- Stenda Photo Booth/Rolling Booth do të jetë një koncept tërheqës dhe funksional për eventin, duke ofruar një përvojë interaktive për vizitorët dhe një dizajn që tërheq vëmendjen. Ajo do të përfshijë ekrane interaktive që lejojnë vizitorët të eksplorojnë përmbajtje multimediale dhe të angazhohen në mënyra inovative, të krijojnë kujtime të menjëhershme përmes një printeri fotografik.

## **15. Qera Hapësire (Zona kryesore e eventit + nje zone pushimi, kapaciteti:te pakten 120 persona/dite)**

- Hapësira e eventit duhet të jetë e pajisur dhe e strukturuar për të ofruar komoditet dhe funksionalitet për të paktën 120 persona, duke përfshirë një sallë konferencash dhe një

---

zonë relaksi. Kapaciteti: Hapësira e konferencës duhet të akomodojë të paktën 120 persona.

#### 16. Karrige te uleta/lounge per zona pushimi (me qera

- Keto karrige do te jene per pjesen e zonen se pushimit, pra te jene mjaft komode per pjesemarresit te cilet duan te shkeputen nga eventit.
- **Dizajni:** Karriget mund të jenë me një pamje moderne, minimaliste, me linja të thjeshta dhe ngjyra neutrale si gri, bezhë, e zezë për t'u përshtatur me çdo ambient.
- Karriget do të kenë përmasa të përshtatshme, me lartësi rreth 40-45 cm dhe gjerësi midis 70-90 cm, duke ofruar hapësirë të mjaftueshme për ulje komode.
- **Materialet:** Strukturë prej druri të qëndrueshëm ose metali të fortë.

#### 17. Tavolina te uleta per zonen e pushimit

- **Dizajni:** Tavolina të thjeshta, të ulëta, në formë drejtkëndëshi ose rrethore, me stil minimalist që përputhen me karriget lounge.
- **Materialet:** Druri natyral ose metal për një pamje të sofistikuar dhe të qëndrueshme.
- **Ngjyrat:** E bardhë, gri, ose ngjyra natyrale druri, por gjithashtu mund të përdoren ngjyra të zeza ose të errëta për kontrast në hapësira më neutrale.

#### 18. Pufte dhe jasteke te rehatshem

- **Forma dhe dizajni:** Pufte në forma të ndryshme (rrethore, katrore, ose drejtkëndëshe) që ofrojnë fleksibilitet në përdorim dhe shtojnë rehati në zonën e pushimit. Jastëkë të mëdhenj dhe të butë, të dizajnuar për mbështetje të mesit apo kokës.
- **Materialet:** Të mbuluara me pëlhura si liri ose kadife për një ndjesi të butë dhe cilësi të lartë.
- **Ngjyrat dhe motivet:** Ngjyra të buta dhe pastel, si edhe mundësia e kombinimit të motiveve delikate për të shtuar stil dhe gjallëri.

#### 19. Shërbim Videografi/Montim 2 ditë

- Shërbimi i videografisë duhet të ofrojë xhirim profesional gjatë eventit, duke përdorur pajisje të avancuara për të siguruar cilësi të lartë. Ekipi i videografisë do të punojë ngushtë me autoritetin kontraktor për të kapur momentet kryesore dhe atmosferën e eventit, duke ofruar një rrëfim vizual të plotë dhe tërheqës.
- Montimi do të përfshijë përpunimin e materialeve të kapura, duke krijuar video të edituara që theksojnë momentet më të rëndësishme. Procesi i montimit do të përfshijë grafikën, muzikën dhe efektet vizuale për të përmirësuar përvojën e shikuesve/audiencës.
- Shërbimi do të përfshijë gjithashtu mundësinë e krijimit të videove promovionale dhe pas-eventit për të rritur dukshmërinë e eventit dhe për të angazhuar më tej audiencën. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që çdo xhirim të ruhet në mënyrë profesionale dhe të ndihmojë në ndarjen e përvojave me një audiencë më të gjerë përmes mediave sociale dhe platformave të tjera dixhitale, sipas kërkesës së autoriteti kontraktor.
- Videografi duhet të garantojë përdorimin e kamerave DSLR, mirrorless ose profesioniste me rezolucion minimal 2K-4K dhe frame rate 30-60 fps, duke shfrytëzuar

---

objektiva si 24-70mm f/2.8 dhe 70-200mm f/2.8, si dhe një objektiv të gjerë për pamje më të gjera. Ai gjithashtu nëse do të nevojiten duhet të përdorë aksesori si gimbal për stabilizim, mikrofon të jashtëm dhe dritat LED, dhe për editimin e materialeve, programet si Premiere Pro, Final Cut Pro dhe/ose të ngjashëm.

- Operatori ekonomik duhet të garantojë qëndrim diskret dhe profesional gjatë gjithë eventit për të mos ndërprerë rrjedhën e ngjarjeve dhe për të respektuar privatësinë e pjesëmarrësve dhe të ruhet anonimati i përdorimit të materialeve. Këto materiale do të konsiderohen pronë e AK-së dhe nuk do të përdoren apo tranferohen drejt palëve të tjera.

## **20. Shërbim Fotografi 2 dite**

- Shërbimi i fotografisë do të ofrojë fotografimin profesional të momenteve gjatë eventit për dy ditë, duke siguruar që çdo aspekt i eventit të dokumentohet në mënyrë të saktë dhe artistike. Fotografët do të përdorin pajisje të avancuara për të garantuar cilësi të lartë të imazheve, duke përfshirë kamera me rezolucion të lartë dhe objektiva të ndryshëm për të kapur detaje të hollësishme dhe pamje të gjera.
- Ky shërbim duhet të përfshijë një mbulim të plotë, duke përfshirë momentet kryesore, interaksionet e pjesëmarrësve dhe atmosferën e përgjithshme.
- Shërbimi i fotografisë do të jetë përgjegjës për përdorimin e pajisjeve teknike të avancuara, përfshirë kamera DSLR ose mirrorless me minimum 24 MP dhe sensor full-frame ose APS-C, objektiva 24-70mm f/2.8, 70-200mm f/2.8, dhe/ose një objektiv të gjerë 16-35mm. Gjithashtu nëse do të nevojiten do përdoren aksesori si tripod, flashe të jashtme dhe filtra, si dhe program për editim si Lightroom, Photoshop dhe/ose të ngjashëm për të siguruar cilësi të lartë në çdo imazh.
- Operatori ekonomik duhet të garantojë qëndrim diskret dhe profesional gjatë gjithë eventit për të mos ndërprerë rrjedhën e ngjarjeve dhe për të respektuar privatësinë e pjesëmarrësve dhe të ruhet anonimati i përdorimit të materialeve. Këto materiale do të konsiderohen pronë e AK-së dhe nuk do të përdoren apo tranferohen drejt palëve të tjera.

## **21. Sistem Live Broadcasting - fb, insta**

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë lidhje interneti të qëndrueshme, me shpejtësi optimale të rrjeteve Wi-Fi ose 4G/5G për një transmetim pa ndërprerje.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë regjistrim audio dhe video me kamera HD (720p ose më shumë) dhe audio të pastër pa zhurma, me bitrate.
- Pajisjet duhet të kenë performancë të mirë dhe të ofrojë procesim të fuqishëm për të ofruar transmetimet “live”, në rrjetet sociale.
- Platforma duhet të mbështesë formate të ndryshme për pajisje dhe rrjete të ndryshme dhe të sigurojë transmetim live pa shkëputje.

## **22. Roll up 85x200 cm**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim
- Format: 85x200 cm
- Printimi: Baner me bojra ekologjike dhe me rezolucion të lartë për ambiente të brendshme
- Mekanizmi aluminit dhe çanta të përfshira: Po



- Materiale rekomandohen të jenë të riciklueshme dhe bojërat e përdorura të jenë me bazë uji për të reduktuar ndikimin mjedisor.

### **23. Televizorë me Rrota ose Mekanizëm Lëvizës**

- Ekran interaktiv/televizor i madhësive 32"-75", i vetëqendrueshëm
- Rezolucioni: Full HD (1920x1080) ose 4K Ultra HD për cilësi të lartë imazhi.
- Teknologjia e prekjes: Infra të kuqe ose kapacitiv me shumë pika prekje (multi-touch) për interaktivitet të lehtë.
- Përfshirja e Anti-glare: Për t'i bërë ekranet më të lexueshme në ambiente me ndriçim të lartë.
- Sistemi operativ: Android i integruar dhe mundësi për lidhje me pajisje Windows apo macOS.
- Aplikacione të parainstaluara: Për menaxhim të prezantimeve, shkrim dore, dhe mësim.
- Porta HDMI, VGA, USB: Për lidhje me pajisje të jashtme si laptopë, kamera, etj.
- Wi-Fi dhe Bluetooth: Për lidhje wireless me pajisje dhe rrjet.
- Ethernet LAN: Për lidhje të qëndrueshme interneti.
- USB-C: Për lidhje të shpejtë dhe furnizim energjie për pajisje të tjera.
- Bokse të integruara: Minimumi 2x10W për cilësi të mirë audioje në dhomat e mëdha.
- Mikrofona: Për funksionet e konferencave ose regjistrimit të zërit.
- Dizajni i vetëqendrueshëm: Konstruksion i qëndrueshëm që lejon të vendoset në çdo hapësirë pa nevojë për montim në mur.
- Rrota të lëvizshme: Për lëvizje të lehtë dhe fleksibilitet.
- Rregullim i lartësisë: Mundësi për ngritje/ulje të ekranit për të lehtësuar përdorimin nga përdorues të ndryshëm.
- Prezantime pa kablo: Lidhje wireless me pajisje të ndryshme për ndarjen e ekranit.
- Stylus për prekje dhe shkrim: Lapsa të posaçëm për shkrim dore në ekran.
- Kamerë e integruar: Për konferenca online dhe video-thirrje.\

### **24. Catering**

- Shërbimi i pritjes duhet të ofrojë një përvojë të veçantë për 100 persona/dite , me koktejl dhe një menu të larmishme që përfshin "fingerfood" dhe ëmbëlsira. Operatori ekonomik duhet të ketë një ekip profesionistësh dhe do të sigurojë shërbim të shkëlqyer dhe një atmosferë miqësore.

### **25. Refreshments (kafe, ujë, çaj)**

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbim me një gamë të larmishme pijesh për eventin, duke përfshirë kafe, çaj dhe ujë për 100 persona/ditë. Ky shërbim do të sigurojë hidratimin dhe relaksim e mysafirëve, duke kontribuar në një atmosferë të këndshme gjatë aktivitetit.

### **26. Trofe / Cmimi i personalizuar për fituesit**

- Te kete një pamje elegante dhe të veçantë.
- I ndërtuar nga materiale të cilësisë së lartë si stinë metalike, akrilik ose xham, trofeu do të ketë një dizajn modern dhe estetik me linja të pastra dhe forma unike.

- 
- Çdo trofe do të personalizohet me emrin e fituesit, datën e eventit dhe kategorinë përkatëse përmes gdhendjes ose gravurës.
  - Dimensionet e tij do të jenë të përshtatshme për të siguruar një prani të dukshme, me lartësi midis 20-30 cm dhe gjerësi deri në 15 cm.
  - Ai do të ofrohet me një ambalazh të sigurt dhe estetik, duke përfshirë një kuti të personalizuar që pasqyron emrin e eventit dhe logon. Të gjitha komponentët do të prodhohen me standarde të larta cilësie për të garantuar që çdo çmim të jetë i qëndrueshëm dhe vizualisht tërheqës, duke e bërë atë një simbol të vlerësimit dhe arritjeve për fituesit.

## **27. Bllok format A5 cover me karton 300gr i printuar me design, letra e brendshme pa viza**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim
- Format: A5 (14.8 cm x 21 cm ose i përafërt), kompakt dhe i lehtë për t'u mbajtur në çantë dhe/ose në dorë.
- Kapaku të jetë karton i trashë afro 300gr./m<sup>2</sup>, i dizenuar dhe i printuar. Printimi duhet të jetë me cilësi të lartë për të ruajtur detajet e dizajnit dhe ngjyrat.
- Brendia: Letër e bardhë offset, me peshë 70-80gr./m<sup>2</sup> me sipërfaqe të lëmuar, të përshtatshme për shkrim me stilolaps, laps ose marker.
- Numri i fletëve: Rreth 50 fletë.
- Libërlidhja: Spirale metalike ose ngjitje në anën e sipërme/anësore për lehtësi në hapje dhe përdorim.

## **28. Stilolapsa të branduar**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim
- Materiali: Eco-plastic
- Printimi/logimi: sipas udhëzuesit të logos duke përdorur teknikat e printimit me bojra UV

## **29. Dosje të branduar**

- Koncepti i dizajnit grafik dhe përgatitja për prodhim
- Materiali: Eco-plastic
- Printimi/logimi: sipas udhëzuesit të logos duke përdorur teknikat e printimit me bojra UV

## **30. Moderator**

- Operatori ekonomik duhet të garantojë pjesëmarrjen në event, akomodimin, transportin dhe minimumi dy vakte ushqimi/dite për moderatorin. Perzgjedhja do të behet nga AK.

## **31. Eksperte të jashtëm**

- 
- Operatori ekonomik duhet të garantojë pjesëmarrjen në event, akomodimin, transportin dhe minimumi dy vakte ushqimi/dite për ekspertet e jashtëm. Perzgjedhja do të bëhet nga AK.

## Shtojca 7.

### Loti 1: “Shërbime për realizimin e eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimi që kërkohet: Realizimi i eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”

Nr.	Emërtimi/Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	LED 4x3m	copë	2
2	Strukturë Layer per 2 Led Wall 4x4m -32m2	m2	32
3	Stage 8x3m	m2	24
4	Dekorimi – tavolina të larta	copë	70
5	Dekorimi – mbulesa të zeza material i plotë	copë	70
6	Ndricimi (LED, pare indoor)	copë	30
7	Shërbim DJ	person	1
8	Ekuipazhi i skenave dhe zërit (teknikët e zërit, teknikët e ndriçimit)	shërbim	1
9	Qera Mikser për DJ	copë	1
10	Prodhim Skenografi/Planimetri të Eventit	copë	1
11	Foltore e Branduar	copë	1
12	Dekorimi Skena - kolltuqe velvet	copë	6
13	Dekorim Skena - karrige te larta	copë	10
14	Dekorimi Skena - tavolina të vogla plexiglass transparente 40x40cm	copë	6
15	Banakë Rregjistrimi, të branduar	copë	2
16	Dekorimi - karrige të ulëta transparente	copë	250

17	Infopoint Corner/Media Booth (një hapësire e branduar akomoduese dhe e pajisur me materiale dixhitale dhe interaktive)	copë	1
18	Infopoint Corner/Media Booth (tabele interaktive) - qira për dy ditë	copë	1
19	Sistemi Audio i Brendshëm (skena me kapacitet 200 +) shërbim për dy ditë	sistem	1
20	Stenda Interaktive Panairi (koncept panairi teknologjie të pajisur me ekrane interaktive, porta elektrike dhe sistem monitorimi)	copë	10
21	Qera Hapësire Multidimensionale, me mundësi akomodimi për skena dhe evente paralele, si dhe hapësire për panairë teknologjie, për të akomoduar në lëvizje dhe hapësira të paktën 500 persona. Kostot janë llogaritur për 3 ditë (1 ditë parapërgatitore dhe 2 ditë event)	copë	1
22	Zhvillimi i brandbook për eventin	shërbim	1
23	Shërbim Videografi/Montim 2 ditë	shërbim	1
24	Shërbim Fotografi 2 ditë	shërbim	1
25	Spote Promovuese 30 sec	copë	15
26	Shërbim Regjie dhe Skenografie	shërbim	1
27	Zhvillim Aplikacioni për Menaxhim Event, me veçori si regjistrimi i përdoruesve, faqet e personalizuara të eventit dhe axhendes, biletat, njoftimet, mjetet e angazhimit të pjesëmarrësve, analitika në kohë reale, listimet e ekspozuesve/sponsorëve, përvojat AR, pagesa të sigurta dhe mbështetje shumëgjuhëshe	shërbim	1
28	Speech to text AI Specifikim: Transkriptim live shqip dhe anglisht dhe shfaqja e tyre në stream	shërbim	1
29	Televizore me Rrota ose Mekanizëm Levizes	copë	10
30	Shërbim për optimizimin e SEO/Google	shërbim	1
31	Shërbim Master of Ceremony	shërbim	1
32	Tarifa për folësit nga Ballkani	person	10
33	Tarifa për folësit nga Europa	person	10
34	Tarifa për folësit nga Amerika/Australi/Azi/Afrike	person	5
35	Pritje me Koktail dhe Catering	150 persona/ditë	1
36	Lunch boxes	250	2

		persona/ditë	
37	Refreshments (kafe, uje, caj)	250 persona/ditë	2
38	Totebags te Branduar	Cope	200
39	Badges	Cope	200
40	Bllok format A5 cover me karton 300gr i printuar me design, letra e brendshme pa viza	Cope	200
41	Stilolapsa të branduar	Cope	200
42	Roll ups 85x 200 cm	Cope	6
43	Shërbim Montim/Cmontim/Transport - nevojiten burime për ngritjen e skenave të ndryshme, rregullimin e ulëseve ose zonave të ekspozitës/panairit	Shërbim	2
44	Koordinim Eventi, gjatë ditëve në terren	Shërbim	1
45	Pishtar zjarri i madh me diameter të pakten 1 metër	Cope	1

**Afatet e ekzekutimit:** Eventi do të realizohet, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

## Shtojca 7.

### Loti 2: “Shërbime për realizimin e eventit: “Gjenerata e Inovacionit”

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimi që kërkohet: Realizimi i eventit: “Gjenerata e Inovacionit”

Nr.	Emërtimi/Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	LED 4x3m	copë	1
2	Strukturë Layer për Led Wall 4x4m	m2	16
3	Stage 4x3m	m2	12
4	Ndricimi (LED, parë indoor)	copë	20
5	Shërbim DJ	person	1
6	Mikser për DJ	copë	1
7	Foltore e Branduar	copë	1
8	Dekorimi Skena - karrige për jurinë	copë	5
9	Dekorim Skena - karrige të larta	copë	2
10	Dekorimi Skena - tavolina për jurinë për 5 veta	copë	1
11	Banake Regjistrimi, te branduar	copë	1
12	Dekorimi - karrige të ulëta	copë	100
13	Sistemi Audio i Brendshëm	sistem	1
14	Photo Booth / rolling booth	copë	1
15	Qera Hapësirë (Zona kryesore e eventit + një zone pushimi, kapaciteti: të paktën 120persona/ditë	ditë	2
16	Karrige të ulëta/lounge për zona pushimi	copë	50
17	Tavolina të ulëta për zonën e pushimit	copë	15
18	Pufte dhe jastekë të rehatshëm	copë	20
19	Shërbim Videografi	shërbim	1
20	Shërbim Fotografi	shërbim	1

21	Sistem Live Broadcasting	shërbim	1
22	Roll up	copë	3
23	Televizor me Rrota ose Mekanizëm Levizës	copë	1
24	Catering	100 persona/ditë	2
25	Refreshments (kafe, uje, caj, biskota)	100 persona/ditë	2
26	Trofe / Cmimi i personalizuar për fituesit	copë	5
27	Bllok format A5 cover me karton 300gr i printuar sipas design, letra e brendshme me viza	copë	100
28	Stilolapsa të branduar	copë	100
29	Dosje të branduar	copë	100
30	Moderator	person	1
31	Ekspert të jashtëm	person	5

**Afatet e ekzekutimit:** Eventi do të realizohet, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.



---

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbime për realizimin e eventeve: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri” dhe “Gjenerata e Inovacionit”, sipas specifikimeve teknike.

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas specifikimeve teknike

---

## Shtojca 9

### Loti 1: “Shërbime për realizimin e eventit: “Flakadani i Bashkimit për Inovacionin në Shqipëri”

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

#### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

##### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e

---

drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

---

## **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2021, 2022, 2023), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës Fotograf
- b) 1 (një) punonjës Videograf
- c) 2 (dy) punonjës Teknik Audio

- 
- d) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
  - e) 2 (dy) punonjës Teknikë Ndriçimi
  - f) 1 (një) punonjës Teknikë Regjie
  - g) 1 (një) punonjës Skenograf
  - h) 1 (një) punonjës Skenarist
  - i) 1 (një) punonjës Zhvillues webi/programues ose ekuivalent
  - j) 1 (një) punonjës DJ
  - k) 1 (një) punonjës Menaxher Eventi

Për punonjësin më sipër duhet të paraqitet :

- kontratë pune ose kontratë shërbimi/angazhimi apo çdo marrëveshje tjetër kontraktuale, të vlefshme gjatë afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, për secilin profil;

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve përkatësisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
- ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqiten:

Çertifikatat përkatëse, objekti i së cilave duhet të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të paktën në datën e hapjes së ofertave.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojnë se:

- Marrin përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, çmontimin dhe largimin e paisjeve pas përfundimit të çdo aktiviteti, të gjitha pajisjet teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit në vendin përkatës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Disponojnë pajisjet teknike për realizimin e objektit të prokurimit, sipas specifikimeve teknike.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

## Shtojca 9

**Loti 2:** “Shërbime për realizimin e eventit: “Gjenerata e Inovacionit”

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar

---

kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

